

# RREGULLORE PËR PUBLICITETIN E SUBJEKTEVE TË LOJËRAVE TË FATIT NË SHQIPËRI

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me publicitetin e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 2

#### Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha subjektet e licencuara për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit Nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

## KREU II

### RREGULLA PËR PUBLICITET

#### Neni 3

#### Publiciteti

1. Publiciteti lejohet të kryhet nga organizatorët e lojërave të fatit të licencuara në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.155/2015, i ndryshuar, si dhe në këtë rregullore:
  - a) në median elektronike, sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
  - b) në *websitet* zyrtare të këtyre subjekteve, sipas përcaktimeve të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
  - c) nëpërmjet vendosjes së materialeve vizuale në vende publike shprehimisht të përcaktuara në ligjin nr.155/2015, i ndryshuar.
2. Publiciteti lejohet të kryhet edhe në median audiovizive nga organizatorët e lojërave të fatit “**baste sportive online**”, “**bingo televizive**” dhe “**lotari kombëtare**” në kushtet si më poshtë:

- a) Nga organizatorët e lojërave të fatit “baste sportive online” gjatë kohës së transmetimit të eventeve sportive, si dhe gjatë kohës së transmetimit të programeve sportive të lidhura me këto evente sportive që transmetohen në intervalin kohor 22:00–08:00, si dhe vetëm në kushtet e parashikuara në ligjin nr.155/2015 të ndryshuar dhe në këtë rregullore.
- b) Nga organizatorët e lojërave të fatit “Lotari Kombëtare” dhe “Bingo televizive” për transmetimet në intervalin kohor ditor 18:00–08:00.

3. Publiciteti lejohet të kryhet nga organizatorët e lojërave të fatit të kategorisë “Kazino”, “Kazino të vendosura në hotele me pesë yje” dhe “Resort Kazino” edhe në ambientet e porteve dhe aeroporteve, sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.

#### **Neni 4**

##### **Kushtet e përgjithshme për publicitetin e lojërave të fatit**

1. Publiciteti i lojërave të fatit duhet të sigurojë që informacioni i transmetuar të jetë i vërtetë, në përputhje me kriteret etike, duke mos keqinformuar lojtarët, në mënyrë që të mos krijojë iluzione se lojërat e fatit mund të zgjidhin problemet/nevojat financiare apo sociale të personave që marrin pjesë në to.
2. Publiciteti duhet të ketë një terminologji të përzgjedhur, duke i kushtuar kujdes të veçantë mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve nën moshën 21 vjeç. Publiciteti i lojërave të fatit nuk mund të adresohet ose të targetojë individë nën moshën 21 vjeç, përjashtimisht në kategoritë e lojërave të fatit “Lotari Kombëtare” dhe “Bingo Televizive”, mosha e lejimit të lojëtarëve nuk mund të jetë nën 18 vjeç.
3. Publiciteti duhet të përmbajë dukshëm frazën “*Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur*”, dhe kjo duhet të evidentohet në cdo formë të tij.
  - a) Mesazhi ndërgjegjësues “*Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur*” të jetë qartësisht i dallueshëm, me gërma të theksuara, të zërë të paktën një të dhjetën e përmasës së publicitetit dhe pa vështirësi leximi nga publiku.
  - b) Në median audiovizive publiciteti duhet të jetë vetëm në formë të shkruar.
  - c) Në publicitetin në median elektronike, teksti i shkruar në këtë nen, duhet të jetë pjesë integrale e faqes kryesore të publicitetit dhe jo në një faqe ose adresë më vete, në mënyrë që të mos shpërqëndrojë fokusin e publikut.

#### **Neni 5**

##### **Ndalimet**

1. Në rastet e lejuara për publicitetin e aktivitetit të lojërave të fatit, organizatorët, kanë të drejtë ta kryejnë atë vetë ose nëpërmjet kontraktorëve, duke respektuar kushtëzimet e mëposhtme:
  - a) Publiciteti nuk duhet të cenojë dinjitetin njerëzor dhe në asnjë rast nuk duhen përdorur terma, imazhe apo elementë të papërshtatshëm që prekin cilëndo kategori të publikut.
  - b) Publiciteti nuk duhet të jetë abuzues dhe i fshehtë, por publiku duhet të informohet në mënyrë të saktë dhe të qartë për rregullat e lojës, veçanërisht lidhur me mundësinë apo shumën e fitimeve.
  - c) Publiciteti nuk duhet të shfrytëzojë ndjeshmërinë e të miturve dhe të rinjve nën moshën 21 vjeç, mungesën e eskperiencë së tyre dhe as të përdorë imazhe, element, apo terma nga të cilat të rinjtë mund të tërhiqen apo ndikohen.
  - d) Publiciteti nuk duhet të përdorë në asnjë rast imazhe të të miturve, apo të rinjve nën moshën 21 vjeç.
  - e) Publiciteti nuk duhet t'i paraqes lojërat e fatit si zgjidhje të problemeve financiare dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen se pjesëmarrja në lojë sjell sukses social e financiar dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës apo reputacionit të individit.
  - f) Publiciteti nuk duhet të krijojë përshtypjen se lojërat e fatit janë një zgjidhje e problemeve të individit dhe as shmangie nga vetmia apo depresioni.
  - g) Publiciteti nuk duhet të inkurajojë konsumatorët për të investuar fitimet në lojë fati.
  - h) Ndalohet publiciteti i aktivitetit të lojërave të fatit gjatë edicionit të lajmeve dhe programeve informative që lidhen me politikën.
  - i) Publiciteti nuk duhet të paraqitet si një mundësi fitimi dhe duhet të kufizohet në qëllimin argetues të lojërave të fatit.

## **Neni 6**

### **Publiciteti në Median Elektronike**

1. Publiciteti për lojërat e fatit në median elektronike duhet të kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe rregullat e caktuara në këtë rregullore.
2. Për publicitetin në median elektronike përveç rregullave të caktuara në nenin 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje duhet të respektohen edhe kushtet si më poshtë:
  - a. Nuk mund të transmetohet publiciteti për lojërat e fatit në ato website apo aplikacione, të cilat janë të dedikuara apo krijuara veçanërisht për të miturit apo të rinjtë nën moshën 21 vjeç, sidomos në faqet që transmetojnë informacione edukative dhe programe argëtuese.
  - b. Nuk mund t'ju dërgohet publicitet/marketing me postë elektronike të gjithë atyre klientëve që kanë kërkuar moslejimin, vetëpërrjashtim apo janë përjashtuar nga pjesëmarrja në lojrat e fatit.

## Neni 7

### Publiciteti në faqet online të autorizuara të këtyre subjekteve

1. Publiciteti në faqet online të autorizuara të këtyre subjekteve për lojërat e fatit duhet të kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe rregullat e caktuara në këtë rregullore.
2. Publiciteti duhet të transmetohet në një seksion të caktuar të faqeve të autorizuara, dhe duhet të përmbajë në çdo rast frazën *“Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur”*.

## Neni 8

### Publiciteti në medien audiovizive

1. Publiciteti në medien audiovizive është vetëm me fjalë të shkruara, ku në çdo rast duhet të paraqitet dukshëm i shkruar me ngjyrë të theksuar, në një madhësi të lexueshme, pa vështirësi për t’u kuptuar nga publiku, duke zënë të paktën një të dhjetat e përmasës së publicitetit fraza *“Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur”*.
2. Në çdo rast duhet të shoqërohet nga logo zyrtare e subjektit, të paktën një website ndihmues dhe numrin e këshillimit nëse ka.
3. Në çdo rast për publicitetin e lojërave të fatit “Baste Sportive online”, “Bingo televizive” dhe “Lotari Kombëtare” duhet të zbatohet orari i përcaktuar në ligjin nr.155/20215, i ndryshuar.
4. Publiciteti në mediat audiovizive në kategorinë “Baste Sportive online” për subjektet e licensuara, nuk mund të shfaqet më shumë se 20 sekonda dhe jo më shumë se 6 herë gjatë zhvillimit të eventit.

## Neni 9

### Publiciteti i lojërave të fatit për kategorinë “Kazino”, “Kazino të vendosura në hotele me pesë yje” dhe “Resort Kazino”

1. Publiciteti i lojërave të fatit për kategorinë “Kazino”, “Kazino të vendosura në hotele me pesë yje” dhe “Resort Kazino”, në ambientet e porteve dhe aeroporteve duhet të kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Lejohet vendosja e materialeve vizuale, shenjave apo tabelave orientuese nga ana e organizatorit të lojërave të fatit të kategorisë “Kazino”, “Kazino të vendosura në hotele me pesë yje” dhe “Resort Kazino” vetëm në hyrjen qendrore të kazinosë. Në çdo rast,

tabela mund të përmbajë vetëm emrin apo brand-in dhe shigjetën drejtuese të orientuar drejt hyrjes së kazinosë.

3. Në hyrjen qendrore të kazinove të vendoset në çdo rast fraza e dukshme, me ngjyrë të theksuar *“Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejkëqatur”*.
4. Publiciteti në median e shkruar dhe audiovizive për kategoritë “Kazino”, “Kazino të vendosura në hotele me pesë yje” dhe “Resort Kazino” është i ndaluar.
5. Çdo formë publiciteti që nuk bie në kundërshtim me përcaktimet në këtë ligj, si tabelë reklamuese fikse apo elektronike, fletëpalosje, banera/banderola, imazhe, mesazhe audio apo video si dhe forma të tjera reklamimi, janë të lejuara në pikat hyrëse të porteve dhe aeroporteve, në çdo rast shoqëruar me mesazhin ndërgjegjësues të përcaktuar në këtë rregullore, në gjuhën shqipe apo gjuhë të tjera.
6. Përvec vendëndodhjeve dhe formave të reklamimit të përcaktuara në këtë nen, ndalohet çdo formë rreklamimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 10**

#### **Publiciteti i lojërave të fatit në ambientet sportive**

1. Lejohet publiciteti vetëm për kategorinë “Baste Sportive online” në mjediset ku zhvillohen aktivitete sportive zyrtare dhe vetëm gjatë kohës së zhvillimit të tërë, me përjashtim të eventeve sportive të të gjitha disiplinave për kategoritë nën moshën 21 vjeç.
2. Lejohet publiciteti vetëm në formë vizuale nga subjektet e kategorisë “Baste Sportive online”.

### **Neni 11**

#### **Sanksionet**

1. Shkelja e përcaktimeve në këtë rregullore, sjell zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 9 të Ligjit 155/2015 ‘Për Lojërat e Fatit’, i ndryshuar.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.